

Jetëshkrimi

Prof. Dr. Sali Berisha.

Sali Berisha, i lindur më 15 tetor 1944, u diplomua me rezultate të shkëlqyera në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 1967. Ai u specializua në degën kardiologji dhe më pas u emërua si asistent profesor mjekësie në të njëjtin universitet dhe mjek kardiolog në Spitalin e Përgjithshëm të Tiranës.

Gjatë viteve 1970, Sali Berisha u dallua për punën kërkimore në fushën e kardiologjisë në Shqipëri dhe u emërua profesor kardiologjie në Universitetin e Tiranës. Në vitin 1986 u zgjodh anëtar i Komitetit Evropian për Kërkime Mjekësore të OBSH-së. Gjatë kësaj periudhe ai botoi një sërë artikujsh në gazeta dhe revista mjekësore prestigjioze të Evropës. Në vitin 1989 iu dha titulli Profesor në Universitetin e Tiranës.

Sali Berisha, pas vdekjes së diktatorit komunist, Enver Hoxha, në vitin 1985, u bë gjithnjë e më aktiv në rrethet e intelektualëve me idetë e tij për ndryshim demokratik dhe për vendosjen në vend të sistemit shumë-partiak. Në fund të viteve '80 Sali Berisha e shprehu mendimin e tij përmes një sërë artikujsh dhe intervistash në disa organe mediatike, asokohe të kontrolluara nga shteti.

Në dhjetor të vitit 1990 ai iu bashkua që në ditën e parë demonstratave të studentëve, të cilat e detyruan regjimin të lejonte sistemin shumëpartiak. Z. Berisha u bë lideri i Partisë Demokratike (PD), partia e parë dhe më e madhe e partive të reja opozitare. Në shkurt të vitit 1991 ai u zgjodh kryetar i PD-së. Megjithëse PD nuk mund të krahasohej me burimet a partisë komuniste në pushtet, në zgjedhjet e para pluraliste, të mbajtura në mars të vitit 1991, fitoi 39 përqind të votës popullore, duke u bërë kështu partia kryesore opozitare në Kuvendin Popullor.

Qeveria e sapo zgjedhur komuniste u rrëzua shpejt në të njëjtin vit nga greva e përgjithshme e organizuar nga sindikata jo-komuniste dhe PD mori pjesë në një qeveri koalicioni, e mandatuar për të stabilizuar vendin dhe për të organizuar zgjedhje të parakohshme. Zgjedhjet parlamentare të marsit të vitit 1992 rezultuan në një ndryshim dramatik të rezultateve të vitit të mëparshëm, ku Partia Demokratike fitoi 62% të votave popullore dhe 92 nga 140 vende në Kuvendin Popullor. Pas dorëheqjes së Presidentit Alia, Kuvendi Popullor i dominuar nga PD-ja, me 8 prill 1992, zgjodhi Sali Berishën si Presidentin e parë të shtetit post-komunist.

Pas zgjedhjes së tij si President i Republikës së Shqipërisë, z. Sali Berisha dhe qeveria e re demokratike u përfshinë në një gamë të gjerë reformash politike, ekonomike, institucionale, legjislative dhe reformash të gjithanshme.

Kështu, një proces i thellë privatizimi i tokës dhe banesave, si dhe i kompanive shtetërore të vogla dhe të mesme u krye gjatë periudhës '92-'96; tregu u liberalizua, ndërkohë që inflacioni u ul në mënyrë drastike dhe PBB u rrit mesatarisht me 9%. Si rezultat i kësaj, në periudhën mes viteve '93 –'96, 75% e PBB-së arrihej nga sektori privat.

Shqipëria u hap ndaj perëndimit; ajo u bë anëtare e Këshillit të Europës në vitin 1995; nënshkroi Marrëshveshjen e Partneritetit për Paqe në vitin 1993 dhe vendosi bashkëpunim të ngushtë me vendet e BE-së dhe SHBA-në.

Të gjitha ligjet e diktaturës komuniste u zëvendësuan me ligje të reja të standarteve evropiane dhe u krijuan një sërë institucionesh, të cilat nuk ekzistonin më parë, si Gjykata Kushtetuese dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Në vitin '97, menjëherë pas revoltave të organizuara nga ish-komunistët, të cilët përfituan nga rënia e skemave mashtruese piramidale, z. Berisha dha dorëheqjen nga detyra e Presidentit, dhe PD-ja kaloi në parti opozitare në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të atij viti. Më pas, ai u rizgjodh Kryetar i Partisë Demokratike dhe këtë pozicion e ka mbajtur që nga viti '97 deri në qershor të vitit 2013, kur ai dha dorëheqjen, pas rotacionit të pushtetit në zgjedhjet parlamentare, të mbajtura në fillim të muajit qershor 2013.

Berisha drejtoi koalicionin e partive të qendrës së djathtë në zgjedhjet e përgjithshme politike, të mbajtura në pesë raunde, në periudhën qershor-gusht 2001. Megjithëse OSBE/ODIHR vuri seriozisht në pikëpyetje lighshmërinë e atyre zgjedhjeve, koalicioni i drejtuar nga PD-ja fitoi 37% të votave. Më 1 korrik 2005, Sali Berisha drejtoi koalicionin e pesë partive të qendrës së djathtë, të cilat fituan një mazhorancë prej 74 deputetësh nga 140 gjithsej në Kuvend. Ai u emërua Kryeministër i Shqipërisë. Në vitin 2009 koalicioni i shumicës qeverisëse, udhëhequr nga Sali Berisha, u rikonfirmua në zgjedhjet parlamentare, të cilat u çertifikuuan nga OSBE/ODIHR-i si zgjedhje që plotësuan shumicën e standarteve ndërkombëtare. Pavarësisht refuzimit nga ana e opozitës për të pranuar rezultatin dhe përpjekjes së dhunshme, në janar të vitit 2011, për të përmbysur qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike, Kryeministri Berisha qëndroi i vendosur për sundimin e ligjit dhe parimet demokratike.

Që nga viti 2005, Sali Berisha si Kryeministër ka përkrahur një numër të gjerë reformash në të gjitha fushat e ekonomisë, legjislacionit, financave, shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes, rendit publik, etj. Një program madhor i investimit në infrastrukturë është zbatuar në të gjithë vendin, duke u fokusuar kryesisht në rrugë dhe infrastrukturën e TIK, ndërkohë që është futur teknologjia moderne digjitale tek regjistri civil, identifikimi i qytetarëve, si dhe kontrolli dhe menaxhimi i integruar i kufirit.

Ai gjithashtu ka drejtuar një fushatë të fuqishme kundër korrupsionit, e cila ka thjeshtuar procedurat burokratike, ka përmirësuar në mënyrë drastike klimën e biznesit, ka futur prokurimet, sistemin e

taksave dhe atë doganor tërësisht elektronike, që rezultuan në një dyfishim të buxhetit të shtetit në katër vjet dhe në një rritje drastike të të ardhurave. Gjatë kësaj periudhe Shqipëria ka nënshkruar dhe zbatuar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me BE-në, u anëtarësua në NATO, aplikoi për statusin e vendit kandidat për në Bashkimin Europian dhe iu dha regjimi i lëvizjes pa viza për qytetarët shqiptarë, në zonën e Shengenit.

Sali Berisha aktualisht është i zgjedhur dhe shërben si deputet i Kuvendit për Partinë Demokratike, partia kryesore opozitare. Ai është i martuar me Liri Ramën, pediatre, dhe kanë dy fëmijë, një vajzë, Argitën, dhe një djalë, Shkëlzenin. Berisha zotëron gjuhën angleze, frënge, italiane dhe ruse.